



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 30

Tiranë – E mërkurë, 22 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe i ministrit të Mirëqenies Sociale nr. 517, datë 24.1.2017	Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim..... 2007
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 824, datë 10.2.2017	Për miratimin e marrëveshjes së performancës, kontratës së performancës (model Tip) për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve..... 2013
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 837, datë 10.2.2017	Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve..... 2022
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 902/3, datë 10.2.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza I, shtesat troje, pjesa lindore”..... 2024
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 1027, datë 16.2.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim urban, shesh park publik, teatri ‘Petro Marko’ ”..... 2024
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Maksim Likaj..... 2025

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 517, datë 24.1.2017****PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE
TË KUALIFIKIMIT TË
UDHËRRËFYESIT TURISTIK DHE
MIRATIMIN E KREDITEVE MINIMALE
TË PROGRAMIT PËR EDUKIMIN
PROFESIONAL NË VAZHDIM**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 59, nenit 60 dhe nenit 68, pika 2 të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, neneve 6, 8 dhe 9, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), nenit 12 dhe 13 të ligjit nr. 10247 datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,

UDHËZOJNË:**Neni 1****Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i sistemit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nivelet e njohurive, të shprehive dhe kompetencave.

Neni 2**Objekti**

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i kritereve dhe procedurave për akreditimin e programeve të kualifikimit profesional të udhërrëfyesit turistik sipas standardeve minimale që duhet të përmbajnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik për çdo kategori përkatëse.

Neni 3**Standardet për akreditimin e programeve të
kualifikimit të udhërrëfyesit turistik**

1. Kërkesat minimale që duhet të përmbajnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, për secilën prej kategorive të udhërrëfyesit turistik të parashikuar sipas legjislacionit në fuqi, përcaktohen në anekset nr. 1, nr. 2, dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik ofrohen nga subjekte të licencuara në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional dhe nga personel me kualifikimin dhe eksperiencën e përshtatshme për modulën përkatës.

3. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik ofrohen duke përdorur metodologji dhe materiale mësimdhënie të përditësuara, duke marrë parasysh nevojat e sektorit përkatës së industrisë së turizmit dhe zhvillimet e fundit të teknologjisë.

4. Subjektet që ofrojnë programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik duhet të sigurohen se kursantët kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm para regjistrimit të tyre për programin e kualifikimit profesional të udhërrëfyesit turistik.

5. Subjekti që ofron programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik detyron kursantët të ndjekin dhe përfundojnë programin e kualifikimit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e plotë gjatë moduleve të trajnimit praktik.

6. Për rinovimin e certifikatës së udhërrëfyesit turistik, ai duhet të plotësojë numrin minimal të krediteve të programit për edukimin profesional në vazhdim sipas aneksit 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 4**Njohja dhe certifikimi i të
nxënit të mëparshëm**

1. Subjektet që ofrojnë programe të akredituara për kualifikimin e udhërrëfyesit turistik njohin të nxënit e mëparshëm, informal dhe formal, të dokumentuar të kursantëve dhe i japin atyre përjashtim nga detyrimi për të ndjekur module specifike të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik në bazë individuale. Modulet e përjashtuara pas njohjes së të nxënit të mëparshëm të kursantit do të konsiderohen se janë përfunduar sipas programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që ofron subjekti.

2. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik që janë përfunduar me sukses nga udhërrëfyesi turistik para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të njihen nga Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike, i ngritur me urdhër të Ministrit përgjegjës për turizmin, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga subjekti i



interesuar, për modulet përkatëse që përkojnë me modulet e programit sipas anekseve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 dhe pas kalimit të një testimi të udhërrëfyesit lidhur me modulet e programit të kualifikimit.

3. Mënyra e njohjes dhe vlerësimit të njohurive të tyre parashikohet në aneksin 5 bashkëlidhur këtij vendimi. Nëse subjekti ka përfunduar me sukses të paktën 60% të krediteve nga secila fushë e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik sipas këtij udhëzimi, ai do të pajiset me një certifikatë paraprake deri në përmbushjen e të gjitha moduleve të programit të miratuar me këtë udhëzim, jo më vonë se 30.9.2018.

4. Pas përfundimit të të gjitha moduleve të programit të kualifikimit, subjekti do të pajiset me certifikatën e udhërrëfyesit sipas nenit 57 të ligjit nr. 93/2015.

Neni 5

Sigurimi i cilësisë së programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik

1. Programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistik akreditohen nga Komisioni i Akreditimit i ngritur me Urdhër të përbashkët të Ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe Ministrit përgjegjës për turizmin. Në përfundim të procesit të akreditimit, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional dhe Ministria përgjegjëse për turizmin japin statusin e programit të akredituar të kualifikimit ose aktiviteteve të akredituara në përputhje me standardet profesionale.

2. Akreditimi i programit të kualifikimit profesional të udhërrëfyesit turistik është i vlefshëm për një afat prej 5 vjetësh.

Neni 6

Procedurat për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik

1. Procesi i akreditimit të programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik bazohet në parimin e vetëvlerësimit. Çdo subjekt që kërkon akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik të ofruara prej tij kryen një raport vetëvlerësimi, bazuar në kriteret sipas këtij udhëzimi.

2. Subjekti që kërkon akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit

turistik që ai ofron, i paraqet Komisionit të Akreditimit, raportin e vetëvlerësimit ose një raport vetëvlerësimi të plotësuar online, si dhe dokumentet provuese, përfshirë kurrikulat e detajuara që ofron subjekti, kualifikimin dhe eksperiencën e personelit trajnues.

3. Komisioni i Akreditimit shqyrton raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentet provuese jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e aplikimit. Brenda këtij afati, Komisioni mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nëse e gjykon të nevojshme.

4. Në rast se vihen re shkelje, pasaktësi të dokumentacionit, mosplotësim i standardeve, Komisioni i Akreditimit i kërkon subjektit plotësimin e mangësive të konstatuara brenda 10 ditëve pune.

5. Brenda 15 ditë pune nga plotësimi i mangësive nga subjekti, Komisioni i Akreditimit përgatit një raport, ku rekomandohet dhënia ose mosdhënia e akreditimit, si dhe evidenca e gjetjeve. Format i për raportin dhe evidencën e gjetjeve përfshin edhe rekomandime për subjektin në lidhje me masat që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit të kualifikimit që ai ofron, nëse ka. Ato janë këshillimore dhe subjekti ka liri veprimi në lidhje me mënyrën e trajtimit të rekomandimeve.

6. Ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në raportin e Komisionit të Akreditimit, marrin vendimin për akreditimin ose mosakreditimin e programit të kualifikimit të ofruar nga subjekti kërkuar, jo më vonë se 10 ditë pune nga data e raportit të Komisionit të Akreditimit.

7. Përgjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, subjektet kontrollohen të paktën një herë në vit për vazhdimësinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe rekomandimeve të dhëna në raport. Në rast të verifikimit të mangësive të konsiderueshme, të cilat sipas mendimit të Komisionit të Akreditimit, nuk mund të ndreqen shpejt ose lehtësisht, i propozohet ministrave përgjegjës, tërheqja e akreditimit.

8. Përjashtohen nga detyrimi për të akredituar programet e kualifikimit për udhërrëfyes turistik sipas këtij udhëzimi institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të lartë.



Diplomat e lëshuara nga këto institucione njihen nga Komisioni i Standardizimit të veprimtarive turistike si dokumente kualifikimi profesional për udhërrëfyesin turistik, me kusht që programet e tyre të përmbajnë kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit sipas anekseve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3.

Neni 7 Ankimi

Ndaj vendimit të Ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe Ministrit përgjegjës për turizmin, subjekti mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletore Zyrtare. Neni 4, pika 2, 3 dhe 4 të këtij udhëzimi do të zbatohen deri në kryerjen e akreditimit të programeve të kualifikimit profesional të udhërrëfyesit turistik.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi

ANEKSI NR. 1 PROGRAMI I KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK KOMBËTAR

Programi i kualifikimit të Udhërrëfyesit turistik kombëtar është hartuar në përputhje me Standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit - Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të guidave turistike profesionale”*, i cili specifikon kërkesat

minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit. Ai thekson rëndësinë e një udhërrëfyesi turistik për të gjithë vendin me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor turistik.

Ky Standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve, rekomandon aftësitë dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike, që duhet të zotërojnë një udhërrëfyes turistik, dhe përcakton trajnimin praktik dhe procedurat e vlerësimit, të cilave duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik kombëtar. Ky standard përcakton gjithashtu normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesit turistik kombëtar duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional, të ndara si më poshtë:

- a) Njohuri mbi Shqipërinë
- b) Njohuri mbi teknikat e guidimit

Ky program mësimor është llogaritur për jo më pak se 600 orë mësimi (teori 180 orë, praktikë 240 orë, autodidakt 180 orë). Autodidakt nënkupton procesin e studimit personal dhe punë kërkimore. Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit kombëtar është 600.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të guidimit.

A. Njohuri mbi vendin

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik kombëtar të jetë i përgatitur për të interpretuar me saktësi trashëgiminë kulturore e mjedisore të vendit dhe të prezantojë me vërtetësi aktualitetin.

1. Mjedisi Fizik dhe Natyra

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

2. Gjeografia Humane dhe Zhvillimi Shoqëror e Urban

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

3. Arkeologjia, Prehistoria dhe Antikiteti Shqipërisë

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

* Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.

**4. Historia e Shqipërisë**

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

5. Diversiteti Kulturor

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

6. Arti & Arkitektura

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

7. Kohët Moderne

(20 orë leksion + 20 orë autodidakt)

8. Praktika dhe mësimi në terren

(20 orë praktikë në terren me profesorin / trajnerin + 20 orë praktikë personale)

B. Njohuri mbi teknikat e guidimit**1. Njohuri dhe Aftësi Profesionale të Udhërrëfyesit Turistik****Aftësi Biznesi dhe Kushtet e Punës**

(40 orë leksion + 40 autodidakt)

2. Ndiqja e Shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm.

3. Praktikë

(136 orë praktikë në terren me profesorin / trajnerin + 64 orë punë kërkimore)

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

ANEKSI NR. 2**PROGRAMI I KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL**

Programi i kualifikimit të Udhërrëfyesit turistik lokal është hartuar në përputhje me Standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit - Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të guidave turistike profesionale”*, i cili specifikon kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet respektive të kualifikimit. Ai thekson rëndësinë e një udhërrëfyesi turistik për një zonë të veçantë të territorit të Shqipërisë (sipas zonave të përcaktuara në pikën b të nenit 4 të kësaj Rregulloreje) me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor turistik.

Ky Standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve,

rekomandon aftësitë dhe njohuritë specifike që duhet të zotërojnë një udhërrëfyes turistik lokal, dhe përcakton trajnimin praktik dhe procedurat e vlerësimit të cilave duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik lokal. Ky standard përcakton gjithashtu normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik lokal.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesve turistikë lokalë duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional të ndara si më poshtë:

a) Njohuri mbi zonën e veçantë

b) Njohuri mbi teknikat e guidimit

Ky program është llogaritur për jo më pak se 320 orë mësimi (teori 96 orë, praktikë 128 orë, autodidakt 96 orë). Autodidakt nënkupton procesin e studimit privat dhe detyrave. Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit lokal 320.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të guidimit.

A. Njohuri mbi zonën e veçantë

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik lokal të jetë i përgatitur për të interpretuar me saktësi trashëgiminë kulturore e mjedisore të zonës dhe të prezantojë me vërtetësi aktualitetin.

1. Mjedi fizik dhe Natyra në Zonën e Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

2. Gjeografia Humane dhe Zhvillimi Shoqëror e Urban në Zonën e Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

3. Arkeologjia, Prehistoria dhe Antikiteti në Zonën e Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

4. Historia e Përgjithshme e Zonës së Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

5. Diversiteti Kulturor i Zonës së Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

6. Arti & Arkitektura në Zonën e Veçantë

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

* Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.



7. Kohët Moderne

(10 orë leksion + 10 orë autodidakt)

8. Praktika dhe mësimi në terren

(10 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 10 praktikë personale)

9. Njohuri të përgjithshme për Shqipërinë

(6 orë leksion)

B. Njohuri mbi teknikat e guidimit

1. Njohuri dhe Aftësi Profesionale të Udhërrëfyesit Turistik

Aftësi Biznesi dhe Kushtet e Punës

(26 orë leksion + 20 orë autodidakt)

2. Ndihma e Shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm

3. Praktikë

(70 orë praktikë në terren me profesorin/trajnerin + 38 orë punë kërkimore)

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

ANEKSI NR. 3

PROGRAMI I KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK TË SPECIALITETIT TË VEÇANTË

Programi i kualifikimit të Udhërrëfyesit turistik të specialitetit të veçantë është hartuar në përputhje me Standardin SSH EN 15565 “Shërbimet e turizmit - Kërkesat për dispozitat e programeve kualifikuese dhe trajnuese të guidave turistike profesionale”*, i cili specifikon kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë të specialitetit të veçantë dhe programet respektive të kualifikimit. Ai thekson rëndësinë e një udhërrëfyesi turistik për një veprimtari të veçantë me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor turistik.

Ky standard specifikon kompetencat dhe qartëson platformën e duhur të trajnimeve, rekomandon aftësitë dhe njohuritë specifike që duhet të zotërojë një udhërrëfyes turistik i specialitetit të veçantë dhe përcakton trajnimin praktik dhe procedurat e vlerësimit, të cilave

duhet t’u nënshtrohet udhërrëfyesi turistik i specialitetit të veçantë. Ky standard përcakton gjithashtu normat dhe kushtet e punës për udhërrëfyesin turistik të specialitetit të veçantë.

Kualifikimi profesional i udhërrëfyesit turistik të specialitetit të veçantë duhet të mbulojë dy fusha kryesore aftësimi profesional të ndara si më poshtë:

a) Njohuri mbi veprimtarinë/specialitetin e veçantë

b) Njohuri mbi teknikat e guidimit

Ky program është llogaritur për jo më pak se 320 orë mësimi (teori 96 orë, praktikë 128 orë, autodidakt 96 orë). Autodidakt nënkupton procesin e studimit privat dhe detyrave. Një orë mësimi (teori, praktikë, autodidakt) është e barasvlershme me 1 kredit. Numri total i krediteve për plotësimin e programit të kualifikimit të udhërrëfyesit të specialitetit të veçantë 320.

Subjekti që ofron programin e kualifikimit profesional vlerëson përvetësimin e njohurive të fituara nga ky program kualifikimi nëpërmjet organizimit të testimit me shkrim dhe demonstrimit praktik të guidimit.

A. Njohuri mbi veprimtarinë/ specialitetin e veçantë

Programi mësimor duhet të jetë i përshtatur në mënyrë që kandidati për udhërrëfyes turistik të specialitetit të veçantë të zotërojë njëkohësisht njohuri të mira dhe aftësi fizike për t’i ofruar turistit, në kushte të larta sigurie, një eksperiencë unike lidhur me temën/objektin e veçantë, duke interpretuar me saktësi të gjithë informacionin rreth kësaj teme/objekti dhe duke prezantuar me vërtetësi aktualitetin.

Për udhërrëfyesit turistikë të turizmit të aventurës, programi duhet të jetë i përshtatur për t’i ofruar udhërrëfyesit turistik njohuritë dhe aftësitë teknike minimale sipas standardit SSH ISO 21102 “Turizmi i Aventurës – Udhëheqësit – Kompetencat e personelit”*.

B. Njohuri mbi teknikat e guidimit

1. Njohuri dhe Aftësi Profesionale të Udhërrëfyesit Turistik

Aftësi Biznesi dhe Kushtet e Punës

(20 orë leksion dhe 26 orë autodidakt)

* Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit informon ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional për çdo ndryshim që mund të pësojë standardi në vite.



2. Ndhimja e Shpejtë

2.1 Certifikatë për trajnimin e ndihmës së shpejtë, e lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose një subjekt tjetër i ngjashëm

3. Praktikë

(70 orë praktikë në terren me profesorin/ trajnerin + 58 orë praktikë personale).

Për turet demonstruese gjatë trajnimit praktik, trajnerët duhet të jenë udhërrëfyes turistikë të certifikuar.

ANEKSI 4

KREDITET MINIMALE TË PROGRAMIT PËR EDUKIMIN PROFESIONAL NË VAZHDIM PËR RINOVIMIN E CERTIFIKATËS

1. Rinovimi i certifikatës për secilën prej kategorive të udhërrëfyesit turistik, bëhet pas plotësimit të numrit minimal të krediteve të përcaktuara në programin e edukimit profesional në vazhdim.

2. Për çdo kategori të udhërrëfyesit turistik, programi i edukimit profesional në vazhdim, parashikon nivelet minimale të orëve. Numri minimal i krediteve i përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi konvertohen në numër minimal orësh sipas raportit 1 kredit – 1 orë, përgjatë periudhës 2-vjeçare të vlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik.

3. Plotësimi i krediteve të përcaktuara në programin e edukimit profesional në vazhdim, sigurohet nëpërmjet këtyre formave të programit:

a) Në kontakt, që nënkupton procesin e pjesëmarrjes në takime profesionale, workshope, seminare, trajnime, konferenca dhe të ngjashme me to. Aktivitetet që ofrojnë kredite për edukimin profesional në vazhdim të udhërrëfyesit turistik akreditohen dhe vlerësohen me kredite nga Komisioni i Akreditimit.

b) Në praktikë, që nënkupton procesin e ushtrimit të veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik.

4. Kreditet minimale që duhet të plotësojë udhërrëfyesi turistik për edukimin profesional në vazhdim janë si më poshtë:

a) Praktikë: 192 orë pune (192 kredite);

b) Në kontakt: 20 orë (20 kredite).

5. Vërtetimi për plotësimin e niveleve minimale të krediteve sipas kësaj rregulloreje provohet me dorëzimin e:

a) Certifikata pjesëmarrje, vërtetime apo dokumente të ngjashme me to, të lëshuara nga subjektet organizatore, që vërtetojnë pjesë-marrjen e personit të interesuar, tematikën e aktivitetit e përshtatshme për veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik sipas kategorisë përkatëse, dhe kohëzgjatjen e aktivitetit, në lidhje me formën “Në kontakt”;

b) Kontrata shërbimi dhe vërtetime pune në lidhje me formën “Në praktikë”.

ANEKSI 5

MËNYRA E NJOHJES DHE VLERËSIMIT TË NJOHURIVE TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK

1. Individët që ushtrojnë veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik dhe që kanë përfunduar me sukses programe kualifikimi të udhërrëfyesit turistik për kategorinë përkatëse para miratimit të këtij udhëzimi, do të aplikojnë pranë Ministrisë përgjegjëse për turizmin, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 05.10.2016.

2. Programet e kualifikimit që kanë përfunduar këta udhërrëfyes do të njihen nga Komisioni i Standardizimit, për sa përkojnë me modulet e programit të kualifikimit siç parashikohen në anekset 1, 2 dhe 3. Për njohjen e këtyre programeve, aplikuesi do të dorëzojë dokumentacion provues, të tilla si:

a) Certifikata të trajnimeve, seminareve, workshope për kategorinë përkatëse të udhërrëfyesit turistik;

b) Programet e trajnimeve, seminareve etj. që ka kryer dhe institucionin ofrues;

c) Certifikatën e vlefshme të ndihmës së shpejtë të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose subjekte të tjera;

d) Vërtetime pune/ kontrata pune/shërbimi ose dokumente të tjera për të vërtetuar eksperiencën në punë gjatë 5 viteve të fundit.

3. Njohuritë e udhërrëfyesit do të vlerësohen nga Komisioni i testimit i ngritur me urdhër të Ministrit përgjegjës për turizmin.

4. Komisioni i testimit përbëhet nga dy përfaqësues të drejtorisë së përgjithshme të zhvillimit të turizmit dhe një trajnues i certifikuar.

5. Komisioni i testimit shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit lidhur me kualifikimet e tyre profesionale dhe kryen testimin e aftësive profesionale të aplikuesve.



6. Dosja e aplikuesit me vlerësimin përkatës nga komisioni i testimit i kalon për shqyrtim Komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike, i cili shqyrton nëse plotësohet i gjithë dokumentacioni i parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 5.10.2016.

7. Nëse komisioni i testimit vlerëson se aplikuesi nuk ka përmbushur kushtet minimale të kualifikimit profesional për t'u pajisur me certifikatë paraprake, Ministria përgjegjëse për turizmin njofton aplikuesin me shkrim për plotësimin e dokumentacionit dhe i cakton atij një afat për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.

UDHËZIM

Nr. 824, datë 10.2.2017

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PERFORMANCËS, KONTRATËS SË PERFORMANCËS (MODEL TIP) PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, dhe lidhjes nr. 1 të saj “Statuti tip i shoqërive aksionere shtetërore të ujësjellës-kanalizimeve”,

UDHËZOJ:

1. Nënshkrimin e Marrëveshjes së performancës midis Agjencisë Kombëtare të Ujësllës-kanalizimeve (AKUK) dhe Bashkisë, sipas lidhjes 1 - Model “Marrëveshje performance”, së bashku me anekset 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këto marrëveshje të monitorohen nga MTI.

2. Nënshkrimin e kontratës së performancës midis Bashkisë/Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Administrimit/Administratorit të Përgjithshëm, sipas lidhjes 2 - Model “Kontratë performance”, së bashku me anekset 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Secili nga dokumentet e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, do të negociohen nga palët nënshkruese dhe do të përshtaten sipas kushteve specifike të secilës shoqëri ujësjellës-kanalizime, por duke ju përmbajtur modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe anekseve përkatëse.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizimeve, të gjitha bashkitë, të gjithë sh.a. Ujësllës-Kanalizime.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj

Lidhja 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizime
Nr. _____ Prot.

BASHKIA

Nr. _____ Prot.

MARRËVESHJE PERFORMANCE (model)

Kjo Marrëveshje, nënshkruhet sot në datën _____, midis **Agjencisë Kombëtare të Ujësllës-Kanalizimeve (AKUK)**, e përfaqësuar nga zoti _____, me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 4, Tiranë, dhe **BASHKISË** _____, me adresë _____, përfaqësuar nga Kryetari i saj, zoti/zonja _____.



PALËT BIEN DAKORD SI MË POSHTË:

1. BAZA LIGJORE DHE KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1.1 Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, në zbatim të: ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”.

1.2 Zbatimi dhe monitorimi i kësaj Marrëveshjeje fillon sot, pas nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë _____ vjeçare.

1.3 Për çdo ndryshim në përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje apo anekseve të saj, për arsye të ecures së procesit të konsolidimit të shoqërisë/shoqërive palët njoftojnë njëra tjetrën, brenda 45 ditësh nga nxjerrja e rezultateve apo ndodhjes së ngjarjes (ndryshim i zonës së juridiksionit/shërbimit të shoqërisë, investimet etj.). Ndryshimet përkatëse do të hyjnë në fuqi vetëm pasi nënshkruhen nga palët dhe ato bëhen pjesë integrale e saj.

2. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje, është përmirësimi i performancës të shoqërisë brenda juridiksionit të Bashkisë/Bashkive, në funksion të arritjes së objektivave strategjike të qeverisë, për plotësimin e kërkesave në rritje të të gjithë popullsisë së vendit, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENCISË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), nëpërmjet autoritetit të saj ligjor e teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror dhe vendor.

3.1 Planifikon nevojat për investime dhe kontrollon e miraton të gjitha projektet e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, të financuara nga buxheti i shtetit apo i bashkive, buxheti i Shoqërive aksionere të Ujësjellës-Kanalizimeve (sh.a. UK) apo institucioneve financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit.

3.2 Ndjek zbatimin e projekteve me financim nga buxheti i shtetit dhe financim të huaj, si dhe të kontratave të lidhura duke qenë përgjegjëse edhe për monitorimin e ecures së tyre, pas vënies në shfrytëzim.

3.3 Është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e metodologjisë për shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit.

3.4 Ka detyrimin ligjor të hartimit të formatit standard të të dhënave (pyetësorit), konfigurimin e programit dhe procedurave që duhet të aplikohen, për zbatimin e procesit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si dhe të ushtrimit të kontroleve me karakter teknik në të gjitha sh.a. UK.

3.5 Përcakton treguesit dhe kriteret e performancës që duhet të arrijë çdo sh.a. UK sipas aneksit 3 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Këto kriteret/tregues performance specifikohen edhe në kontratën e performancës që lidh Asambleja e Përgjithshme e sh.a. UK me Këshillin e Administrimit të sh.a. UK.

3.6 AKUK-ja planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën me të gjithë aktorët për realizimin e procesit të trajnimit e certifikimit të stafit të sh.a. UK.

3.7 Koordinon nismat për investime në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, si dhe përgatit projekte zhvillimore apo pilot, me kërkesën e bashkive, qarqeve dhe institucioneve qendrore.

3.8 Informon Bashkinë/Asamblenë e Përgjithshme për të dhënat dhe treguesit e performancës së sh.a. UK, në mënyrë elektronike për çdo tremujor dhe në format të printuar 2 herë në vit (çdo gjashtëmujor), pas përfundimit të procedurave të monitorimit.

3.9 Organizon dhe zhvillon seminare mbi analizën e performancës së çdo sh.a. UK-je, si dhe për sektorin në tërësi, ku është e nevojshme të marrin pjesë, jo vetëm anëtarët e Këshillit të Administrimit por edhe përfaqësues të Asamblesë së Përgjithshme të sh.a. UK.



4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BASHKISË

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë do të realizohen drejtpërdrejt nga kjo e fundit, në cilësinë e aksionerit/aksionerëve të sh.a. UK _____:

4.1 Bashkia, brenda zonës së juridiksionit të saj, është përgjegjëse për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet shoqërisë aksionere në pronësi të saj. Zona e juridiksionit të Bashkisë dhe zona e shërbimit të sh.a. UK-së, specifikohen përkatësisht në anekset 1 dhe 2 të kësaj marrëveshje.

a) Në ushtrimin e funksioneve të veta, Bashkia do të garantojë zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me Statutin e sh.a. UK-së;

b) Kodin e ujit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009;

c) Ligjin nr. 8102 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar me ligjin nr. 9915, datë 12.5.2008;

d) Çdo ligj tjetër, VKM, udhëzues apo akt nënligjor;

4.2 Bashkia mbështet sh.a. UK në procesin e evidentimit të të gjithë konsumatorëve të shërbimeve që ofron shoqëria, moslejimin e lidhjeve të pa ligjshme dhe faturimin e plotë të të gjithë klientëve sipas natyrës së tyre dhe cilësisë së shërbimeve që ata marrin.

4.3 Bashkia, si pronare e sh.a. UK-së, duhet të kontribuojë për mbledhjen e të ardhurave nga konsumatorët familjarë dhe të sigurojë që të gjitha institucionet apo bizneset që operojnë në juridiksionin e saj, të paguajnë në kohë faturat për shërbimet e përfituara nga sh.a. UK.

4.4 Bashkia, në asnjë rast nuk duhet të mos shlyejë detyrimet që ajo vetë ka kundrejt sh.a. UK për shërbimet e ofruara prej saj, pavarësisht se Bashkia është pronarja e saj.

4.5 Bashkia, duhet të mbështesë shoqërinë, për zbatimin e investimeve të identifikuar në plan biznes, të cilat janë përcaktuar si të domosdoshme për arritjen e objektivave të saj për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për UK&ITUN për komunitetin e tyre, në funksion të plotësimit të objektivave strategjike të qeverisë për këto shërbime.

4.6 Bashkia, brenda kapaciteteve të saj financiare, duhet të sigurojë investime nga buxheti lokal, të japë hua apo të garantojë hua edhe nëpërmjet mbështetjes së saj në procesin e ndryshimit të tarifave të shërbimeve, deri në arritjen e efikasitetit të plotë financiar të shoqërisë.

4.7 Asambleja e Përgjithshme e sh.a. UK-së përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, ka përgjegjësinë e lidhjes së një kontratë pune me Këshillin e Administrimit të Shoqërisë, në të cilën përcaktohen kriteret dhe objektivat që duhet të arrihen nga shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, shprehur këto nëpërmjet treguesve të performancës.

4.8 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të sh.a. UK-së, miraton Plan Biznesin 5-vjeçar të hartuar nga shoqëria sipas procedurave statutores të saj,

4.9 Bashkia në përputhje me kompetencat e saj, ka të drejtë të shprehet në lidhje me propozimin e sh.a. UK-së drejtuar Entit Rregullator të Ujit, për ndryshimin e tarifave të shërbimeve që ofron shoqëria.

5. MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SHOQËRISË

AKUK-ja informon Bashkinë dhe MTI në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me kërkesat e Programit të Monitorimit dhe Vlerësimit Krahasues të Treguesve të Performancës “Benchmarking”. Të dhënat raportohen çdo tre muaj me bazë mujore dhe treguesit e performancës llogariten me bazë tremujore. Procesi i Monitorimit do të zhvillohet si më poshtë:

- Për rezultatet e tremujorit të parë të vitit _____ (treguesit e performancës sipas aneksit 3), AKUK-ja do të njoftojë, Asamblenë e Përgjithshme/Bashkinë dhe Këshillin e Administrimit të sh.a. UK. Këta tregues do të shërbejnë si bazë krahasimi për periudhën e dytë të monitorimit (gjashtëmujor);

- Bazuar në vlerësimin krahasues të treguesve për këtë periudhë (tremujori i dytë kundrejt të parit), AKUK-ja analizon trendin e performancës të shoqërisë dhe në rast se trendi rezulton negativ, ajo informon Asamblenë e Përgjithshme/Bashkinë për marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e menaxhimit;

- Në përfundim të periudhës së tretë monitoruese (9-mujore), bazuar në vlerësimin krahasues të treguesve për këtë periudhë (9-mujori kundrejt 6-mujorit), AKUK-ja analizon trendin e performancës të



Shoqërisë dhe në rast se trendi rezulton negativ, ajo informon Asamblenë e Përgjithshme/Bashkinë për marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin e Këshillit të Administrimit;

- Në fund të vitit _____ pas mbylljes së procedurave të monitorimit, AKUK-ja bën analizë të hollësishme të treguesve të performancës. Në rast se trendi vazhdon të jetë negativ, AKUK-ja merr në administrim të përkohshëm Shoqërinë e Ujësjetllës-kanalizimeve sipas akteve ligjore në fuqi.

6. PROCEDURAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

***Shënim:** Duke marrë në konsideratë faktin se viti 2017 është viti i parë gjatë të cilit shoqëritë e ujësjetllës-kanalizimeve do të funksionojnë sipas specifikimeve të bëra në VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe në përputhje me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për këtë arsye të dhënat dhe treguesit e tyre nuk mund të krahasohen me ato të vitit 2015 apo 2016. Zona e juridiksionit dhe ajo e shërbimit të shoqërive UK për vitin 2017 nuk përputhet në asnjë rast me atë të vitit 2015, pasi në këtë vit mënyra e organizimit e funksionimit të tyre kishte një tjetër formë dhe bazë ligjore.*

Viti 2016, gjatë të cilit u miratuan aktet ligjore e nënligjore të reformës dhe filloi riorganizimi i shoqërive, gjithashtu nuk mund të shërbejë si bazë krahasimi për treguesit e performancës dhe objektivat.

Për sa më sipër, viti 2017 do të shërbejë si vit test dhe sqarojmë se AKUK, do të njoftojë Bashkinë për rezultatet e shoqërisë çdo tremujor dhe ato do shërbejnë si bazë krahasimi në vazhdimësi. Mbi këtë bazë sqarojmë se kjo Marrëveshje do të rishikohet në përputhje me ecurinë e procesit.

Drejtor i Përgjithshëm
(AKUK)

Kryetari i Bashkisë

Aneksi 1

BASHKIA _____

ZONA E JURIDIKSIONIT TË BASHKISË QË NË BAZË TË VKM-së NR. 63, PËRPUTHET ME ATË TË SHOQËRISË UK

	Njësitë administrative të Bashkisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

Aneksi 2

SHOQËRIA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE _____ ZONA E SHËRBIMIT TË SHOQËRISË UK

	Njësitë administrative të Bashkisë	Qytetet dhe fshatrat që u ofrohet shërbimi furnizimit me ujë të pijshëm	Popullsia
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			



Aneksi 3

Treguesi	Njësia	Rezultate orientuese		Viti 2017 bazë për vlerësimin krahasues			
		Viti 2015	Viti 2016	Tremujori I	6/ mujori	9/ mujori	Viti 2017
Mbulimi me ujësjellës	%	81.43					
a) Mbulimi me ujësjellës - urbane	%	90.44					
b) Mbulimi me ujësjellës - rurale	%	62.59					
Mbulimi me kanalizime	%	50.09					
Prodhimi i ujit ($l/f/d$)	l/frymë/ditë	280.75					
Konsumi i energjisë (kwh/m^3)	kwh/m ³	1.19					
Shitjet e ujit - familjare ($l/f/d$)	l/frymë/ditë	71.41					
Ujë pa të ardhura - %	%	66.70					
Përqindja e lidhjeve me ujëmatës	%	63.52					
Norma e arkëtimit - e përgjithshme	%	91.93					
Norma e arkëtimit - F	%	92.01					
Norma e arkëtimit - EP	%	92.39					
Norma e arkëtimit - IN	%	112.57					
Mbulimi i KDO – të ardhurat	%	99.55					
Mbulimi i KDO - arkëtimet	%	91.52					
Staf për 1000 lidhje U+K	Raport	5.53					
Vazhdimësia e shërbimit ($Ore/dite$)	orë/ditë	12.00					
Norma e sigurisë (klori mbetës)	%	96.05					
Norma e sigurisë (koliforme)	%	99.47					
Mbulimi i KTO me të ardhurat (U&K)	%	75.03					
Mbulimi i KTO - arkëtime (U&K)	%	68.98					
Mbulimi i KTO me arkëtimet nga të gjitha burimet	%	80.56					
Niveli i faturimit	%	33.30					

Treguesi	Njësia	Viti 2017 bazë për vlerësimin krahasues			
		Tremujori I	6/ mujori	9/ mujori	Viti 2017
Mbulimi me shërbimin e ITUN	%				
Mbulimi me ITUN nëpërmjet kanalizimeve	%				
Mbulimi me ITUN nëpërmjet gropave septike	%				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**BASHKISË** _____

Nr. _____ Prot. _____

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT**Sh.a. UK** _____

Nr. _____ Prot. _____

**KONTRATË PERFORMANCE
(model)**

Kjo Kontratë, nënshkruhet sot më datë _____, midis **Asamblesë së Përgjithshme të Bashkisë** _____, përfaqësuar nga kryetari i saj z./znj. _____ dhe **Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime** _____, përfaqësuar nga Administratori Ekzekutiv i saj, z./znj. _____.

PALËT BIEN DAKORD SI MË POSHTË:**1. BAZA LIGJORE DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

1.1 Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate, në zbatim të: ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-kanalizimeve”.

1.2 Zbatimi dhe monitorimi i kësaj kontrate performance, fillon sot pas nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare.

1.3 Për çdo ndryshim në përmbajtjen e kësaj kontrate apo anekseve të saj, për arsye të ecures së procesit të konsolidimit të shoqërisë/shoqërive UK, Asambleja e Përgjithshme e Bashkisë/Bashkive, njofton Këshillin e Administrimit të shoqërisë brenda 45 ditësh nga nxjerrja e rezultateve apo ndodhjes së ngjarjes (ndryshim i zonës së juridiksionit/shërbimit të shoqërisë, investimet etj.). Kontrata e Performancës, me ndryshimet përkatëse, duhet të rinënshkruhet, në mbledhjen më të parë mes palëve.

2. QËLLIMI I KONTRATËS SË PERFORMANCËS

2.1 Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për të gjithë konsumatorët e këtyre shërbimeve brenda juridiksionit të Bashkisë/bashkive.

2.2 Përmirësimi i performancës së shoqërisë ujësjiellës-kanalizime, funksionimi i saj si një entitet tregtar dhe krijimi i të gjitha mundësive për arritjen e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet gjenerimit të të ardhurave të nevojshme për mbulimin e kostove të shërbimeve.

3. PËRGJEGJËSITË E ASAMBLËSË SË PËRGJITHSHME/BASHKISË

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, do të realizohen drejtpërdrejt nga kjo e fundit, në përputhje të plotë me VKM-në nr. 63, datë 27.1.2016 dhe statutin e shoqërisë aksionere të ujësjiellës-kanalizimeve _____. Bashkia, brenda zonës së juridiksionit, është përgjegjëse për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet shoqërisë aksionere në pronësi të saj. Zona e juridiksionit të bashkisë dhe zona e shërbimit të shoqërisë UK, specifikohen përkatësisht në anekset 1 dhe 2 të kësaj kontrate. Përveç sa është përcaktuar në këto akte, Asambleja e Përgjithshme e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, ka detyra si më poshtë:

3.1 Në ushtrimin e funksioneve të veta, Asambleja, garanton zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me: Statutin e shoqërisë ujësjiellës-kanalizime, Kodin e Ujit, të miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009; ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar; si dhe çdo ligj tjetër, apo akt nënligjor.



3.2 Nëpërmjet kompetencave të veta ligjore, Bashkia do të koordinojë punët, investimet dhe ndërhyrjet në infrastrukturën lokale në mënyrë të tillë që të garantojë jo vetëm zbatimin brenda afateve të projekteve UK, por edhe të eliminojë në maksimum dëmtimet në infrastrukturën UK.

3.3 Asambleja e Përgjithshme do të mbështesë sh.a. UK në procesin e evidentimit të të gjithë konsumatorëve të shërbimeve që ofron shoqëria, moslejimin e lidhjeve të paligjshme dhe faturimin e plotë të të gjithë klientëve sipas natyrës së tyre dhe cilësisë së shërbimeve që ata marrin.

3.4 Me mekanizmat ligjore që bashkia disponon, si pronare e sh.a. UK, do të kontribuojë për mbledhjen e të ardhurave nga konsumatorët familjarë dhe do të sigurojë që të gjitha institucionet apo bizneset që operojnë në juridiksionin e saj, të paguajnë në kohë faturat për shërbimet e përfituara nga sh.a. UK.

3.5 Asambleja e Përgjithshme garanton se institucioni i bashkisë, në asnjë rast nuk do të lërë pa shlyer detyrimet që ka kundrejt sh.a. UK-së për shërbimet e përfituara prej saj.

3.6 Asambleja e Përgjithshme/Bashkia, do të mbështesë shoqërinë, për zbatimin e investimeve të identifikuar në plan biznesin e miratuar prej saj, të cilat janë përcaktuar si të domosdoshme për arritjen e objektivave të bashkisë, në funksion të plotësimit të objektivave strategjike të qeverisë për këto shërbime.

3.7 Asambleja e Përgjithshme do të bëjë përpjekje maksimale që brenda kapaciteteve financiare të bashkisë, të bëjë të mundur sigurimin e investimeve nga buxheti lokal, të japë hua apo të garantojë hua për sh.a. UK.

3.8 Asambleja e Përgjithshme, garanton monitorimin e kësaj kontrate performance lidhur me Këshillin e Administrimit të shoqërisë, në të cilën përcaktohen kriteret dhe objektivat që duhet të arrihen nga shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, shprehur këto nëpërmjet treguesve të performancës në aneksin 3 të saj.

3.9 Asambleja e Përgjithshme/Bashkia do të përdorë të gjitha kompetencat duke u shprehur në mbështetje të shoqërisë në lidhje me propozimin e bërë prej saj në procesin e ndryshimit të mirëargumentuar të tarifave.

3.10 Asambleja e Përgjithshme/Bashkia në bashkëpunim me Këshillin e Administrimit të shoqërisë duhet të organizojë dhe zhvillojë transparencën me publikun për tarifat e propozuara ERRU-së.

4. PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË UK

Këshilli i Administrimit i përbërë nga tre administratorët e zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së sh.a. UK-së. Përveç sa është specifikuar në statutin e shoqërisë Këshilli i Administrimit ka përgjegjësitë sa më poshtë vijon:

4.1 Do të mirëmenaxhojë të gjitha burimet e sh.a. UK-së në funksion të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore, me kosto sa më të ulët e me tarifat e duhura për të gjithë zonën e juridiksionit të saj, duke respektuar standardet e këtyre shërbimeve.

4.2 Këshilli i Administrimit do të organizojë punën në mënyrë të tillë që ti garantojë shoqërisë mirëmbajtjen, zhvillimin dhe ruajtjen e aseteve të veta.

4.3 Administratorët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo udhëzim të nxjerrë nga Bashkia, MTI (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve) apo institucione të tjera, për sa i përket shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve e trajtimit të ujërave të ndotura.

4.4 Këshilli i Administrimit do të shqyrtojë, miratojë dhe përditësojë planet e biznesit të hartuara nga shoqëria dhe do të orientojë punën drejt arritjes së ekonomisë së shkallës.

4.5 Nëpërmjet kompetencave të veta ligjore, Këshilli i Administrimit do të bëjë përpjekje maksimale për të rritur kapacitetin e shfrytëzimit të aktiveve të qëndrueshme dhe do të krijojë të gjitha mundësitë për rritjen e kapaciteteve njerëzore.

4.6 Këshilli i Administrimit siguron edhe nëpërmjet kësaj kontrate, se do të përdorë me efikasitet të gjitha burimet financiare të shoqërisë.

4.7 Është përgjegjësi e Këshillit të Administrimit të zbatojë procedurat e programit të monitorimit, përcaktuar nga AKUK-ja dhe miratuar nga ministri i MTI-së, për sa i përket zbatimit të afateve dhe mbajtjes e raportimit të të dhënave të sakta, për shërbimet e ofruara prej sh.a. UK-së.



4.8 Këshilli i Administrimit, do të bëjë përpjekje maksimale për arritjen e objektivave të shoqërisë shprehur këto nëpërmjet treguesve të punës sipas përcaktimeve të bëra në këtë kontratë.

4.9 Si organ i vetëm që ushtron funksione administrimi e mbikëqyrje, Këshilli i Administrimit do të angazhohet në lidhje me shlyerjen e detyrimeve kontraktuale që sh.a. UK ka ndaj të tretëve.

4.10 Këshilli i Administrimit do të organizojë dhe zhvillojë transparencën me publikun për sa i përket ndryshimit të tarifave dhe planit të investimeve në infrastrukturën e UK & ITUN.

5. MONITORIMI I KONTRATËS SË PERFORMANCËS

Monitorimi i Kontratës së Performancës do të kryhet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe treguesit e performancës do të monitorohen nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, e cila informon Bashkinë dhe Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës në mënyrë të vazhdueshme.

6. PROCEDURAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

Problemet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen në përputhje me VKM-në nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe statutit tip të shoqërisë aksionere bashkëlidhur tij.

Shënim. Duke marrë në konsideratë faktin se viti 2017 është viti i parë gjatë të cilit shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të funksionojnë sipas specifikimeve të bëra në VKM-në nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe në përputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për këtë arsye të dhënat dhe treguesit e tyre nuk mund të krahasohen me ato të vitit 2015 apo 2016. Zona e juridiksionit dhe ajo e shërbimit të shoqërive UK për vitin 2017 nuk përputhet në asnjë rast me atë të vitit 2015, pasi në këtë vit mënyra e organizimit e funksionimit të tyre kishte një tjetër formë dhe bazë ligjore. Viti 2016, gjatë të cilit u miratuan aktet ligjore e nënligjore të reformës dhe filloi riorganizimi i shoqërive, gjithashtu nuk mund të shërbejë si bazë krahasimi për treguesit e performancës dhe objektivat. Për sa më sipër, viti 2017 do të shërbejë si vit test dhe sqarojmë se AKUK-ja do të njoftojë Bashkinë për rezultatet e shoqërisë çdo tremujor dhe ato do shërbejnë si bazë krahasimi në vazhdimësi. Mbi këtë bazë sqarojmë se kjo Kontratë do të rishikohet në përputhje me ecurinë e procesit.

Asambleja e Përgjithshme
Kryetari

Këshilli i Administrimit
Administratori i Përgjithshëm

Aneksi 1 BASHKIA

ZONA E JURIDIKSIONIT TË BASHKISË QË NË BAZË TË VKM-së NR. 63, PËRPUTHET ME ATË TË SHOQËRISË UK

	Njësitë administrative të Bashkisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të Njërive administrative	Popullsia
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

**Aneksi 2**
SHOQËRIA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE _____
ZONA E SHËRBIMIT TË SHOQËRISË UK

	Njësitë administrative të Bashkisë	Qytetet dhe fshatrat që u ofrohet shërbimi furnizimit me ujë të pijshëm	Popullsia
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

Aneksi 3

Treguesi	Njësia	Rezultate orientuese		Viti 2017 bazë për vlerësimin krahasues			
		Viti 2015	Viti 2016	Tremujori I	6/ mujori	9/ mujori	Viti 2017
Mbulimi me ujësjellës	%	81.43					
a) Mbulimi me ujësjellës - urbane	%	90.44					
b) Mbulimi me ujësjellës - rurale	%	62.59					
Mbulimi me kanalizime	%	50.09					
Prodhiimi i ujit ($l/f/d$)	l/frymë/ditë	280.75					
Konsumi i energjisë (kwh/m^3)	kwh/m ³	1.19					
Shitjet e ujit - familjare ($l/f/d$)	l/frymë/ditë	71.41					
Ujë pa të ardhura - %	%	66.70					
Përqindja e lidhjeve me ujëmatës	%	63.52					
Norma e arkëtimit- e përgjithshme	%	91.93					
Norma e arkëtimit - F	%	92.01					
Norma e arkëtimit - EP	%	92.39					
Norma e arkëtimit - IN	%	112.57					
Mbulimi i KDO - të ardhurat	%	99.55					
Mbulimi i KDO - arkëtimet	%	91.52					
Staf për 1000 lidhje U+K	Raport	5.53					
Vazhdimësia e shërbimit (<i>Ore/dite</i>)	orë/ditë	12.00					
Norma e sigurisë (klori mbetës)	%	96.05					
Norma e sigurisë (koliforme)	%	99.47					
Mbulimi i KTO me të ardhurat (U&K)	%	75.03					
Mbulimi i KTO - arkëtime (U&K)	%	68.98					
Mbulimi i KTO me arkëtimet nga të gjitha burimet	%	80.56					
Niveli i faturimit	%	33.30					

Treguesi	Njësia	Viti 2017 bazë për vlerësimin krahasues			
		Tremujori I	6/ mujori	9/ mujori	Viti 2017
Mbulimi me shërbimin e ITUN	%				
Mbulimi me ITUN nëpërmjet kanalizimeve	%				
Mbulimi me ITUN nëpërmjet gropave septike	%				



UDHËZIM

Nr. 837, datë 10.2.2017

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE
SHTETËRORE PËR OFRUESIT E
SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”,

UDHËZOJ:

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, të gjitha bashkitë, të gjithë sh.a. ujësjellës-kanalizime.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj

Lidhja 1

METODOLOGJI

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E
SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE**

Kjo metodologji është hartuar në zbatim të VKM-së nr. 504, datë 6.7.2016 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, kreut III “Përgjegjësitë dhe detyrat e AKUK-së”, pika 2, germa “dh”, dhe në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

Detajimi i fondit të subvencionit për çdo shoqëri aksionere të ujësjellës-kanalizimeve (sh.a. UK), dhe përdorimi i tij nga përfituesit, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni i sh.a. UK, me aksionerë bashkitë përkatëse, që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, akordohet nga AKUK-ja.

2. Akordimi i subvencionit do të bëhet në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me VKM.

3. Shuma e kompensimit (subvencionit) dhe mënyra e llogaritjes së tij, bëhen në përputhje të plotë me kapitullin V “Kompensimi”, të VKM-së nr. 650, datë 16.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurës për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik ndihmën shtetërore”.

4. Vlerësimi i nevojave për subvencione, si dhe detajimi dhe shpërndarja e subvencionit nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, do të bazohet në:

4.1 Të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve sh.a. UK, në Njësinë e Monitorimit të AKUK-së, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara në manualin e programit të monitorimit dhe vlerësimit krahasues të treguesve të performancës “Benchmarking”.

4.2 Në ecurinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në kontratat e performancës, lidhur ndërmjet palëve (sipas akteve ligjore në fuqi).

Treguesit që do të merren në konsideratë për shpërndarjen e subvencionit sipas pikës (5.2) do të jenë: (uji pa të ardhura; norma e arkëtimit; raporti i mbulimit të kostos me të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve) me anë të të cilëve llogaritet koeficienti i performancës mbi bazën e të cilit renditen shoqëritë sipas performancës, lidhur ngushtë me tregues të tjerë si pesha specifike e kostove të punës dhe energjisë elektrike në koston totale të shërbimeve, staf/1000 lidhje UK etj.



5. Subvencioni i përfituar sipas pikës 3 të kësaj metodologjie do të përdoret nga sh.a. UK

5.1 Për të përballuar mbulimin e “Kostos neto” (Diferencën = Të ardhura – Kosto totale e operim/mirëmbajtjes), për të tria shërbimet publike që ofrohen në sektor: a) Furnizim me ujë të pijshëm; b) Kanalizime; c) Trajtim e përpunim të ujërave të ndotura;

5.2 Për të nxitur përmirësimin e performancës së sh.a. UK që operojnë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

6. Skema e ndarjes së fondeve për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 5, për vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të jenë:

6.1 80% e fondit të përgjithshëm të subvencionit do të shkojë për përballimin e “Kostos neto” (në rastet e shoqërive me vlerë negative të saj).

6.2 20% e fondit të përgjithshëm do të përdoret nga shoqëritë që përmirësojnë performancën e tyre krahasuar me rezultatet e vitit të kaluar.

7. Përfshihen nga përfitimi i subvencionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6.1 të kësaj metodologjie, të gjitha shoqëritë e UK, “Kosto neto” e të cilave rezulton me vlerë 0 ose është vlerë pozitive.

8. Përfshihen nga përfitimi i subvencioneve sipas përcaktimit të bërë në pikën 6.2 të kësaj metodologjie, shoqëritë e UK që janë brenda skemës së subvencionimit, në rastet kur:

8.1 Nuk është firmosur marrëveshja e performancës midis AKUK dhe bashkisë përkatëse;

8.2 Nuk është firmosur një kontratë performance/menaxheriale, midis Bashkisë/Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Administrimit/Administratorit të Përgjithshëm;

8.3 Nuk kanë arritur objektivat e treguesve të performancës të cilësuar në marrëveshjen dhe kontratën përkatëse.

9. Subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, do të përdoret sipas përcaktimeve si më poshtë:

9.1 Në rastin kur fondi i subvencionit është dhënë me destinacion përballimin e “Kostos neto”, ai do të përdoret për të paguar pagat dhe sigurimet shëndetësore e shoqërore të punonjësve, faturat e energjisë elektrike, materialeve të konsumuara dhe kimikateve.

9.2 Në rastin e përfitimit të subvencionit, për arsye të përmirësimit të performancës, shoqëria mund ta përdorë këtë fond, për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet kapitale të aseteve që zakonisht mbulohen nga vlera e amortizimit, pa tejkaluar vlerën e tij në koston e vitit.

10. AKUK-ja, bazuar në vlerësimin e performancës të sh.a. UK-ve, çdo vit i propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, metodologjinë dhe skemën që duhet të zbatohet për ndarjen e fondeve sipas përcaktimeve të bëra në pikat 6.1 dhe 6.2 të kësaj metodologjie, si dhe renditjen e shoqërive sipas performancës.

11. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, e cila bën çeljen e fondit të subvencioneve për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ushtron kontrolle periodike për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar, për çdo ofrues shërbimi apo shoqëri që ka përfituar nga skema e subvencionimit.

**KËRKESË****Nr. 902/3, datë 10.2.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza I, shtesat troje, pjesa lindore”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive

që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 35,061,322.25 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e dy) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRIË SË
ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani**

**LISTA E PASURIVE TE PALUAJTSHME PRONE PRIVATE PLOTESIM NE PJESIN LINDORE, QE PREKEN NGA PROJEKTI VIJA BREGDETARE
E QYTETIT TE VLORES FAZA I**

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe truallit	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit lekë	Vlera e truallit, lekë	Vlera e banesës, lekë	Vlera truall dhe ndërtësë ose truall dhe banesë	Shënime
8602	41/388	Dhurata Velaj	1117.26		10,903		12,181,485.78	0	12,181,485.78	Konfirmuar nga ZVRPP, Vlorë. Kjo pronë ka mbivendosje
8602	41/394	Dhurata Velaj	863.67		10,903		9,416,594.01		9,416,594.01	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlorë
8602	41/389	Liri Velaj	97.7		10,903		1,065,223.10		1,065,223.10	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlorë
8602	41/397	E.Gega, K.Zaimaj	1137.12		10,903		12,398,019.36		12,398,019.36	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlorë

35,061,322.25

KËRKESË**Nr. 1027, datë 16.2.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim urban, shesh park publik, teatri ‘Petro Marko’”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 22,420,781 (njëzet e dy milionë e katërqind e njëzet mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRIË SË
ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani**



LISTA E PASURIVE QE PREKEN NGA PROJEKTI:
“RIKUALIFIKIM URBAN, SHESH PARK PUBLIK TEATRI “PETRO MARKO”“

Çmimi i truallit sipas vkm 89/2016

Çmimi per banesat konform VKM 138 date 23.03.2000 konfirmuar sipas ZVRPP

Çmimi per njesite e sherbimit , konform VKM 138 date 23.03.2000 sipas cmimeve te EKB

Nr	ZK	Nr. Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe Truallit	Sipërfaqe Ndërtimit	Çmimi i Truallit Lekë/m ²	Çmimi i Ndërtimit Lekë/m ²	Vlera e Truallit Lekë	Vlera e Ndërtimit Lekë	Vlera e Truall dhe Ndërtësë	Shënime
1	8603	23/9	Vlore	Shtet (truall ne sherbim te Pallatit)	155.87							Konfirmuar nga ZVRPP
2	8603	23/10	Vlore	shtet	862.75							Konfirmuar nga ZVRPP
3	8603	23/47	Vlore	Shtet (truall ne sherbim te Pallatit)	14.83							Konfirmuar nga ZVRPP
4	8603	23/100	Vlore	shtet	18.7							Konfirmuar nga ZVRPP
5	8603	23/105	Vlore	Lulezim Begaj	69		10,903		752,307	0	752,307	Konfirmuar nga ZVRPP
6	8603	23/101-T	Vlore	Bp Begaj	156		10,903		1,700,868	0	1,700,868	Konfirmuar nga ZVRPP
7	8603	23/105-ND	Vlore	Lulezim Begaj		55						konfirmuar nga ZVRPP.Objekti nuk ekziston , referuar relacionit shpjegues , bashkelidhur.
8	8603	23/101-ND	Vlore	Bashkim Begaj		108						konfirmuar nga ZVRPP.Objekti nuk ekziston , referuar relacionit shpjegues , bashkelidhur.
9	8603	22/64	Vlore	shtet	357.42							Konfirmuar nga ZVRPP
10	8603	23/98	Vlore	shtet	21.4							Konfirmuar nga ZVRPP
11	8603	23/99	Vlore	Belina Fejzaj	200	160	10,903		2,180,600	2,559,028	4,739,628	Konfirmuar nga ZVRPP Hipotekohet ne favor te Bakes Kombetare te Greqise. Vlera e katit per dhe me destinacion njesi sherbimi dhene sipas situacionit te punimeve.

						160		46,136.20	0	7,381,792	7,381,792	Vlera e katit te dyte me destinacion objekt banimi dhene sipas cmimit te ZVRPP , zbritur vlera e truallit (shkresa bashkelidhur)
12	8603	23/11-T	Vlore	shtet	108.4							Konfirmuar nga ZVRPP
13	8603	23/11-ND	Vlore	shtet		108.4	10,903	0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP.Objekti nuk ekziston ne terren
14	8603	23/96	Vlore	shtet	2396							Konfirmuar nga ZVRPP
15	8603	23/66	Vlore	shtet	236.13							Konfirmuar nga ZVRPP
16	8603	22/98	Vlore	Shtet (truall ne sherbim te Pallatit)	24.48							Konfirmuar nga ZVRPP
17	8603	22/112-ND	Vlore	objekt shites e banese		15.65			0	758,978	2,276,934	Konfirmuar nga ZVRPP, 3 kate
18	8602	1/9	Vlore	shtet shesh para teatrit Petro Marko	468.33							Konfirmuar nga ZVRPP
19	8602	1/22	Vlore	shtet	29.76							Konfirmuar nga ZVRPP
20	8602	1/7	Vlore	shtet	72.17							Konfirmuar nga ZVRPP
21	8603	23/200	Vlore	Artan Ferati	143	60.5	10,903		1,559,129	0	1,559,129	Konfirmuara nga ZVRPP. Urdher kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkelidhur
22	8603	23/210	Vlore	Aleks Ahmataj	128.8	74.2	10,903		1,404,306	0	1,404,306	Konfirmuara nga ZVRPP. Urdher kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkelidhur
23	8603	23/201	Vlore	Mustafa Tartari	239	90	10,903		2,605,817	0	2,605,817	Konfirmuara nga ZVRPP. Urdher kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkelidhur

22,420,781

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 50(13-2017-161), datë 17.1.2017, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Maksim Likaj, i datëlindjes 31.1.1950, duke përcaktuar si ditë të vdekjes së tij datën 1.1.1992.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë